



Ambasada
e Republikës Federale të Gjermanisë
Tiranë

Fletë informacioni për njohjen e diplomave të studimeve të larta për qëllime udhëtimi në Gjermani me Kartën Blu/BE ose për kërkimin e një vendi pune

Një vizë pune apo për kërkimin e një vendi pune në Gjermani si punëmarrës i mirëkualifikuar me diplomë universitare mund të jepet vetëm nëse diploma juaj e studimeve të larta njihet si **e barazvlefshme** në Gjermani.

Nëse diploma juaj e shkollës së lartë është e krahasueshme me një diplomë gjermane këtë mund ta verifikoni në Bazën e të Dhënave ANABIN:

<http://anabin.kmk.org/>

Nëse diploma juaj / shkolla e lartë **nuk** është e regjistruar në këtë Bazë të Dhënash, atëherë duhet të bëni **vlerësimin e diplomës suaj** nga Zyra Qendrore për Arsimin me Jashtë (ZAB).

Për këtë qëllim duhet të dërgoni të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në adresën:

Zentralstelle für ausländisches Bildungswesen (ZAB)

Im Sekretariat der Kultusministerkonferenz

Graurheindorfer Str. 157

53117 Bonn

Informacione të mëtejshme mund të merrni në faqen: <http://www.kmk.org/zab>

Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.